



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 27.12.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri.

Munguan : Etem Arifi, Daut Haradinaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (KDI, OSBE), media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19.12.2011,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguri bërthamore, sipas rekomandimit të Komisioni për buxhet,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.12.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.12.2011.

3. Shqyrtimi i projektligjit për Agjencinë e mbrojtjes nga rrezatimet dhe siguria nukleare

Kryetari Nait Hasani pasi që konstatoi se për këtë projektligj kanë mbetur ca dilema, komisioni ishte i mendimit se duhet të shqyrtohen ato por pas vitit të ri, ndaj me një votim formal u vendos që amendamentet e propozuara dhe vërejtjet e komisionit për buxhet do të shqyrtohen në mbledhjen e parë pas vitit të ri bashkërisht me propozuesin e Projektligjit, kur fillon sesioni pranveror. **Liburn Aliu** u angazhua për modelin Slloven ku Agjencia e ka vendin në ministrinë përkatëse, pasi që kjo i përshtatet edhe Kosovës, mirëpo **kryetari** tha se u vendos që kjo çështje të mbetet për vendosje pas pushimeve të fund dhe fillim vitit.

4. Të ndryshme

Në kuadër të kësaj pike u shqyrtuan si vijon :

Për **Projektligjin për Qendrën historike të Prizrenit** u vendos që grupi punues të jetë po ai i cili është për Hoçën : **Liburn Aliu**-kryesues, **Daut Haradinaj**, **Salih Morina**, **Sevdije Lama**, **Nait Hasani**, **Hetem Arifi** dhe **Rasim Demiri**. **Nait Hasani** potencoi faktin se komisioni duhet të niset nga konstatimi i ekspertit apo ekspertëve se a japin vizën për kalim të këtyre dy ligjeve apo jo, ngase fjala është për barazinë që flet Kushtetuta : barazia fetare. **Gjejlane Hoxha** në vazhdim sqaroi komisionit propozimin e saj rreth ekspertëve që i propozon për dy projektligjet në fjalë (Hoça dhe Prizreni). Për Prizrenin ajo tha se studimi është i kryer nga profesoresha e fushës përkatëse **NURAN ZEZEN GYLENSOY**, ndërsa propozoi edhe **ROB PICKARD** nga KE i cili ka dhënë dorëheqjen për shkak të mospajtimeve. Eksperti **SOLAR** i propozuar nga **Liburn Aliu** gjithashtu mbetet si opcion. Për Hoçën ajo tha se nuk ka studim por vet emri i ligjit është kontestues. Me këta ekspert, vazhdoi ajo, duhet të bisedohet a pranojnë të japin ekspertizën. **Liburn Aliu** arsyetoi propozimin për ekspertin Izraelit z. Solar ngase është i paanshëm në çdo aspekt.

Kryetari i Komisionit përfundoi me konstatimin se këta ekspert do të njoftohen përmes adresave elektronike për kërkesat e sotme të komisionit, a pranojnë dhe si pranojnë të japin ekspertizat e tyre për këtë komision.

Për **Projektligjin për Bujqësinë Organike** formohet grupi punues : **Nijazi Idrizi**-kryesues, **Afërdita Berisha** dhe **Sevdije Lama**.

Për **Projektligjin për Bjeshkët e Nemuna dhe Sharrin**, formohet grupi punues : **Nait Hasani**-kryesues, **Afërdita Berisha**, **Sevdije Lama** dhe **Liburn Aliu**. **Nijazi Idrizi** ishte i mendimit se duhet fillimisht të vjen Projektligji për pyje (është premtuar nga ministria për Janar 2012) pastaj të shqyrtohen këto dy projektligje, ngase duhet së pari të definohen ca gjëra të rëndësishme që duhet të janë kompatible mes vedi. **Ylber Sherifi** tha se me të drejtë kërkon deputeti këtë analizë ngase ligji aktual i pyjeve në nenin 7 thotë se Agjencia e pyjeve është përgjegjëse edhe me menaxhimin dhe administrimin e pyjeve edhe në parqet nacionale (Ligji për Pyje dhe për parqe duhet të janë në harmoni).

Arbnor Hoxha dhe **Fatos Lajçi** u propozuan ekspert profesional për këto dy projekte, ndërsa eksperti ligjor do të propozohet nga kryetari i komisionit. Për ekspertin e propozuar nga **Sevdije Lama** z. Arbnor Hoxha u kërkuar të prezantoi në mbledhjen e radhës për shkak të harmonizimit të disa fakteve të cekura në CV-në e tij personale.

Nait Hasani në fund **njoftoi** komisionin për punën e këtij komisioni prej marsit deri në dhjetor 2011 kur i ka mbajtur 40 mbledhje dhe shumë aktivitete tjera (sipas raportit të dorëzuar) dhe konstatoi se nëse krahasohet me punën e komisioneve tjera (nisur nga viti 2001), asnjë komision (funksional) deri tani nuk ka punuar më tepër : jashtëzakonisht efikas. Duke konstatuar këtë fakt, ai ftoi komisionin me mysafirë prezent, në një drekë të fundvitit.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani